

# STATUTI I SHOQERISE “MEDITERRANEAN SAFFRON” SHPK.

Sot me 09.04.2021, ne te nenshkuarit:

- **Z. Benjamin Bejko**, shtetas shqiptar, lindur ne Berat, me 24/09/1966, mbajtes i kartes se identitetit me nr. 034503943\_
- **Z. Gentian Bejko**, shtetas shqiptar, lindur ne Lezhe me 09/09/1973, mbajtes i kartes se identitetit me nr. 034786961
- **Z. Abele Bejko**, shtetas shqiptar, lindur ne Bologna Italy, me 09/07/1995, mbajtes i kartes se identitetit me nr. 032103770

Nenshkuajme kete statut per krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin “Mediterranean Saffron” Shpk. (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

## TITULLI I EMERTIMI, OBJEKTI, ZYRA QENDRORE, KOHEZGJATJA

### Neni 1 – Forma

- 1.1. Shoqeria eshe themeluar si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar dhe aktiviteti i saj rregullohet ne baze te ketij statuti dhe aktit te themelimit.
- 1.2. Shoqeria e zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

### Neni 2 – Emertimi

Emertimi i Shoqerise eshte “Mediterranean Saffron” Shpk.

### Neni 3 – Objekti

Objekti i shoqerise “Mediterranean Saffron” Shpk, do te jete me kete objekt: Import-Exportin e Shafranit dhe te produkteve me shafran, alkalike dhe jo alkalike, perpunim shafrani dhe prodhimin e produkteve me shafran, alkalike dhe jo alkalike, tregtim me shumice e pakice te ketyre produkteve, blerjen shitjen ose marrjen apo dhenien me qera te stabilimentit ku punohet, sistemimin dhe pershtatjen e

stabilimentit sipas nevojave, blerjen, shitjen dhe marrjen ose dhenien me qera te makinerive, paisjeve dhe gjithckaje tjeter qe sherben per te kryer veprimtarine e saj normale, sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi. Kohezgjatja e aktivitetit te kesaj shoqerie do te jete pa afat.

#### **Neni 4 – Zyra Qendrore dhe Stabilimenti**

- 4.1. Shoqeria e ka Zyren Qendrore te saj ne adresen: Njesia Bashkiake nr.8, Rr.Riza Cerova, Pall Xhajs, Shk. N.2, Ap 20, Tirane, Shqiperi.
- 4.2. Stabilimenti i Perpunit, i shoqerise “Mediterranean Saffron” Shpk, ndodhet ne adresen: Rr. Riza Cerova Pall Xhajs, Kati -1, Tirane, Shqiperi.
- 4.3. Ortaket e Shoqerise mund te vendosin transferimin e zyres qendrore te Shoqerise dhe stabilimentin e perpunitit ne nje vend tjeter, ose mund te vendosin hapjen e mbylljen e stabilimenteve te reja, apo zyrave te perfaqesimit te Shoqerise, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise.

#### **Neni 5 – Kohezgjatja**

- 5.1. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje afat kohor te pakufizuar.
- 5.2. Kohezgjatja e Shoqerise mund te zgjatet ose Shoqeria mund te priset dhe te likujdohet perpara perfundimit te afatit te siperpermendur, me vendim te Ortakeve te Shoqerise.

#### **Neni 6 – Pergjegjesite**

- 6.1. Shoqeria nuk eshte pergjegjese per detyrime te marra persiper, ne kundertshtim me kete statut dhe me aktin e saj te themelimit.
- 6.2. Shoqeria nuk eshte pergjegjese per detyrime te marra persiper nga ortaket e saj ne emerin e tyre personal perkundrejt te treteve.

## **TITULLI II KAPITALI**

## **Neni 7 – Kapitali**

- 7.1. **“Mediterranean Saffron” Shpk** do te kete nje kapital fillestar minimal prej 100.000 (Njeqindmije) Leke ose kundervlera e tij ne dollare amerikane (US\$) ose ne monedhen europiane (Euro).
- 7.2. Kapitali themeltar i Shoqerise eshte i ndare ne 3 (tre) pjese, te gjitha te nenshkruara e te shlyera nga Ortaket, z. Benjamin Bejko, z. Gentian Bejko dhe z. Abele Bejko .

## **Neni 8 – Kontributet dhe pjeset e kapitalit**

- 8.1. Pjeset e kapitali themeltar te Shoqerise prej 100.000 (njeqindmije) leke, ndahen si vijon:
  1. **Z. Benjamin Bejko**, zoteron 1 (nje) pjese, qe perben 40% te kapitalit Themeltar, me vleren 40.0000 (dyzetemije) leke.
  2. **Z. Gentian Bejko**, zoteron 1 (nje) pjese, qe perben 40% te kapitalit Themeltar, me vleren 40.0000 (dyzetemije) leke.
  3. **Z. Abele Bejko**, zoteron 1 (nje) pjese, qe perben 20% te kapitalit Themeltar, me vleren 20.0000 (njezetemije) leke.

## **Neni 9 – Zmadhimi i kapitalit**

- 9.1. Ortaket e Shoqerise mund ta zmadhoje kapitalin e Shoqerise.
- 9.2. Per zmadhimin e kapitalit, Ortaket e Shoqerise kane te drejte te nenshkruajne pjeset e reja te kapitalit qe do te zmadhohet.

## **Neni 10 – Zvogelimi i kapitalit**

- 10.1. Ortaket e Shoqerise, mund te vendosin mbi zvogelimin e kapitalit te Shoqerise. Ne çdo rast kapitali nuk mund te zvogelohet me shume se minimumi i kerkuar nga ligji.
- 10.2. Zvogelimi i kapitalit te Shoqerise i prek ortaket ne perputhje me pjeset e kapitalit qe ata zoterojne.

## **Neni 11 – Transferimi i pjeseve te kapitalit**

11.1. Pjeset e kapitalit mund te transferohen te ortake te rinj, pjeserisht apo teresisht, vetem me Vendim unanim te tre Ortakeve.

### **TITULLI III**

## **VENDIMET E ORTAKEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI**

### **Neni 12 –**

Ortaket e shoqerise, me vendimet e tyre vendosin ne lidhje me sa vijon:

- emerimin dhe zevendesimin e administratorit/ve dhe te ekspertit kontabel (nese eshte i emeruar);
- miratimin e te gjitha planeve te prodhimit, organizimit, zhvillimit te aktivitetit, buxhetit, bilancit vjetor, raporteve te administrimit dhe ato te ekspertit kontabel, si dhe inventaret;
- ndryshimet e statutit;
- hapjen e stabilimeteve, filialeve, zyrave te perfaqesimit jashte vendit;
- zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit;
- ndryshimin e objektit te shoqerise si dhe shitjen e pjeseve te kapitalit nje shoqerie tjeter;
- transferimin e pjeseve te kapitalit;
- emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve;
- ndarjen e fitimeve dhe te rezerves ligjore.

### **Neni 13 – Administrimi**

- 13.1. Shoqeria do te administrohet nga nje Perfaqesues Ligjor.
- 13.2. Perfaqesuesi Ligjor ka te gjitha kompetencat e administrimit te zakonshem ne lidhje me objektin e shoqerise, me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji apo statuti i shoqerise ia njej shprehimisht Ortakeve te Shoqerise.
- 13.3. Ortaket e shoqerise ne çdo moment kane te drejte te kontrollojne, personalisht apo nepermjet nje perfaqesuesi, atehere kur e shohin te arsyeshme, dhe pa asnje kufizim, veprimtarine e Perfaqesuesit ligjor. Cdo vendim i marre nga ortaket ne kundërshtim me parashikimet e ketij paragrafi, do te konsiderohet i pavlefshem.

### **Neni 14 - Eksperti Kontabel**

- 14.1. Nëse është e nevojshme apo nëse kërkohet nga ligji, revizionimi i bilancave dhe librave kontabel të Shoqërisë, do të bëhet nga një ekspert kontabel i autorizuar, i emëruar për një periudhë prej 2 (dy) vjetësh, me mundësi emërimi për një afat tjetër, me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.
- 14.2. Eksperti kontabel i autorizuar mund të shkarkohet me të njëjten procedurë.

## **TITULLI IV**

### **VITI FINANCIAR, BILANCI, SHPERNDARJA E FITIMIT**

#### **Neni 15 – Viti financiar dhe bilanci vjetor**

- 15.1. Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të çdo viti.
- 15.2. Viti i parë financiar përjashtimisht fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit (QKR) dhe përfundon me 31 Dhjetor të po atij viti.
- 15.3. Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventaret, raportet e Përfaqësuesit Ligjor dhe ekspertit kontabel (nëse është i emëruar), miratohen me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.
- 15.4. Dokumentat që lidhen me vitin financiar, duhet të miratohen brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

#### **Neni 16 – Fitimet**

- 16.1. Fitimet që do të rezultojnë nga bilanci vjetor, pasi të jenë zbritur ato shuma që Ortaket, me vendim të tyre i destinohen në reserve, do t'i shpërndahet ortakëve të Shoqërisë.
- 16.2. Ortaket e shoqërisë, kur e shohin të arsyeshme, me vendim të tyre, mund të marrin vendim për të krijuar rezervë të veçanta ose të jashtëzakonshme për qëllime të veçanta, edhe në rast të shtyrjes së shpërndarjes së fitimit pjesërisht apo tërësisht.

## **TITULLI V**

### **PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

## **Neni 17 – Prishja**

- 17.1. Shoqeria mund te prishet ne çdo kohe, me vendim te Ortakeve te Shoqerise.
- 17.2. Shoqeria nuk mund te prishet ne rast pamundesie per te vepruar, pazotesie juridike per te vepruar, vdekje, likuidimi apo falimentimi te njerit apo te treve, prej Ortakeve te shoqerise.

## **Neni 18 – Likuidimi**

- 18.1. Ne rast prishjeje, shoqeria duhet te likuidohet.
- 18.2. Per perndjekjen e kesaj procedure, Ortaket emerojne nje apo me shume likuidues, te cilet duhet te pergatisin nje raport perfundimtar mbi asetet dhe detyrimet e shoqerise, si dhe mbi veprimet e procedures se likuidimit dhe kohes se nevojshme per likuidimin.
- 18.3. Ne perfundim te procedures se likuidimit, Ortaket e Shoqerise do te vendosin, bazuar ne bilancin vjetor perfundimtar, punen e kryer nga likuiduesi/t dhe perfundimin e procesit te likuidimit.
- 18.4. Pasi te jene shlyer te gjithe kreditorët dhe debite e tjera, likuiduesi/t do te shperndajne te ardhurat e mbetura te perftuara nga likuidimi, tek Ortaket e shoqerise.

## **Neni 19 – Transformimi ne nje shoqeri tjeter**

- 19.1. Shoqeria mund te transformohet ne nje shoqeri kolektive me vendim te ortakeve te Shoqerise, dhe mund te transformohet gjithashtu ne nje shoqeri anonime me vendim te ortakeve te Shoqerise.

## **Neni 20 -- Zgjidhja e mosmarreshjeve**

- 20.1 Te gjitha mosmarreshjet qe do te lindin ndermjet paleve lidhur me interpretimin apo zbatimin e statutit dhe aktit te themelimit, do te zgjidhen me mirekuptim ndermjet paleve.
- 20.2 Atehere kur kjo nuk do te jete e mundur, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, do te jete organi kompetent per zgjidhjen e tyre.

## **Neni 21 – Gjuha e Statutit**


Ky statut hartohet ne 5 (pese) kopje, ne gjuhen shqipe me vlere te barabarte juridike secila.




Nenshkuar sot me date 09.04.2021

**ORTAKET E SHOQERISE**

**Benjamin Bejko**



**Gentian Bejko**



**Abele Bejko**

